



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 162 dt.11.08.1994

PER
SHPALLJE “DESHMOR TE ATDHEUT” Z. MIKEL LARO.

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e kësaj date pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Organizimit për shpalljen “Dëshmor të Atdheut” Z. Mikel Laro, ekonomist në Stomatologjinë e Universitetit

Vëren se :

Mikel Laro, lindur në Korçë, në Tetor 1958, banues në Tiranë Rr.e “Kavajës”, Pallati.150, Shk.2, Ap.11, ishte rritur me ndjenjën e urrejtjes ndaj diktaturës komuniste. Ai i shte një nga pjesëmarrësit më aktivë të lëvizjes demokratike një agjikator dhe propagandues i flaktë i saj. Më dt.30.03.1991 ai goditet nga ish – sigurimi dhe enveristët të cilët e plagosin rëndë, ku mbas 5 ditësh vdes. Z. Mikel Laro me dekretin Nr.531, më dt.04.05.1993 të Presidentit të Republikës, Z. Sali Berisha i është dhënë medalja “Martir i Demokracisë”. Në këto kushte, mbështetur në dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor Nr.4558, dt.18.10.1969

VENDOSI

1. Të shpalli “Dëshmor të Atdheut” Z. Mikel Laro.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA